



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës,

Në mbështetje të nenit 40, paragrafi. 17 , nenin 41 paragrafi 6 dhe 42 paragrafi. 8 të Ligjit Nr.08/L-237, për Kadastër të pronës së pa luajtshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2/09 Janar 2024), nenit 11, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr.34/22 dt. 18.11.2022), si dhe nenit 38 paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare Nr.15, 12.09.2011),

Nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MMPHI) Nr. 08/2024 PËR KOMISIONET PËR RINDËRTIMIN E KADASTRIT DHE REGJISTRIT TË DREJTAVE MBI PRONËN E PALUAJTËSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim përcaktimin e mënyrës së zgjedhjes dhe kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët për t'u emëruar kryesues, zëvendës kryesues apo anëtar të komisionit, apo nën komisioneve, mandatin, përgjegjësit, kompetencat dhe mënyrën e marrjes së vendimeve të Komisioneve për Rindërtimin e Kadastrit dhe Regjistrin të të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme.

Neni 2
Fushëveprimi

Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ zbatohen nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, Komisionet për Rindërtimin e kadastrit, Zyrat Kadastrale Komunale, dhe institucionet e përfshira në procesin e rindërtimin e kadastrit.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ e kanë kuptimin e njëjtë me përkufizimet në Ligjin Nr. 08/L-237 për Kadastër të Pronës së Paluajtshme.

2. Në kuptim të këtij Udhëzimi Administrativ emrat në gjininë mashkullore nënkuptojnë edhe emrat në gjininë femërore dhe anasjelltas, pa diskriminim.

Neni 4

Komisionet për Rindërtimin e Kadastrit

1. Për rindërtimin e kadastrit, formohen:

1.1. Komisioni për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Zyrtarizimit të Gjendjes Faktike dhe Mospërputhjeve me RDPP; dhe

1.2. Komisioni për Plotësimin ose Korrigjimin e të Dhënave në Kadastër.

Neni 5

Emërimi dhe përbërja e Komisionit për shqyrtimin dhe vendosjen e zyrtarizimit të gjendjes faktike dhe mospërputhjeve me RDPP

1. Komisioni për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Zyrtarizimit të Gjendjes Faktike dhe Mospërputhjeve me RDPP, përbëhet nga tre (3) anëtarë:

1.1. Një profesionist nga fusha e të drejtave pronësore, i propozuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, kryesues;

1.2. Një profesionist nga fusha juridike, i propozuar nga Zyra e Kryeministrit, anëtar; dhe

1.3. Një profesionist nga fusha e gjeodezisë dhe kadastrit, i propozuar nga AKK, anëtar.

2. Kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit, me rastin e emërimit u caktohen zëvendësit e tyre.

3. Emërimin e anëtarëve të Komisionit e bënë Qeveria e Republikës së Kosovës sipas propozimit të institucioneve nga paragrafi 1 i këtij neni të cilin Qeverisë ia dërgon Agjencia Kadastrale e Kosovës përmes Ministrisë.

4. Anëtarët e Komisionit caktohen për kohën sa zgjat projekti i caktuar i rindërtimit të kadastrit.

Neni 6

Kushtet që duhet të plotësojnë kandidatët për kryesues, zëvendës kryesues dhe anëtarë të Komisionit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Zyrtarizimit të Gjendjes Faktike dhe Mospërputhjeve me RDPP

1. Kryesues apo zëvendës kryesues i Komisionit mund të zgjidhet personi që i plotëson kushtet si vijon:

- 1.1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
 - 1.2. Të gëzojë integritet personal dhe profesional;
 - 1.3. Të jetë i diplomuar në fakultetin juridik sipas programit katër (4) vjeçar ose ka përfunduar studimet e magjistraturës në Republikën e Kosovës ose në ndonjë fakultet juridik të një vendi tjetër, pas nostrifikimit të diplomës në Republikën e Kosovës;
 - 1.4. Të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune në fushën juridike, lëmia e pronave;
2. Anëtarët e Komisionit dhe zëvendësit e tyre, përveç përgatitjes profesionale nga neni 5 duhet të kenë edhe së paku tri (3) vite përvojë pune në fushën përkatëse.

Neni 7

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Komisionit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Zyrtarizmit të Gjendjes Faktike dhe Mospërputhjeve me RDPP

1. Kompetencat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë:
 - 1.1. Shqyrtimi dhe vendosja për njohjen dhe zyrtarizimin e të drejtave pronësore jo kontestimore mbi pronat e paluajtshme për rastet e trashëgimive të pa formalizuara për të cilat nuk ka pasur azhurnime në regjistër pas fillimit të funksionimit të sistemit Noterial në Kosovë;
 - 1.2. Shqyrtimi dhe vendosja për njohjen e pronësisë në rastet e shitblerjeve sipas marrëveshjes jo formale/gojore, të cilat kanë mbetur të pa zyrtarizuara para fillimit të projektit të rindërtimit të kadastrit;
 - 1.3. Mbikëqyrja e organizimit të fushatës, në bashkëpunim me nën komisionin, për sensibilizimin e banorëve të ZK/komunës ku zbatohet rindërtimi i kadastrit si dhe publikut të gjerë.
 - 1.4. Koordinimi i aktiviteteve dhe bashkëpunimi me AKK, dhe OE, lidhur me marrjen dhe shkëmbimin e informatave dhe pranimit dorëzimit të të dhënave;
 - 1.5. Bashkëpunimi me institucionet dhe personat me autorizime publike për kryerjen e trashëgimive dhe njohjen e të drejtës pronësore për transaksionet me marrëveshje jo formale/gojore;
 - 1.6. Pranimi i regjistrimit të kërkesave pronësore nga Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronave dhe nga institucionet tjera dhe dorëzimi tek nën komisioni përkatës dhe OE;
 - 1.7. Hapja e shikimit publik duke përfshirë:

1.7.1. shpallja e datës së shikimit publik të të dhënave nga procesi i rindërtimit;

1.7.2 mbikëqyrja në organizimin dhe udhëheqjen e fazës së shikimit publik sipas planit të zbatimit të rindërtimit.

1.8. Shqyrtimi i kërkesave dhe i ankesave të pronarëve, mbajtja e seancave dëgjimore për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave, si dhe nxjerrja e vendimeve për secilin rast të paraqitur gjatë shikimit publik;

1.9. Komisioni vendimet i merr pas rekomandimeve të nën komisionit nga neni 11 paragrafi 1 të këtij Udhëzimi Administrativ;

1.10. Përgatitja e raporteve të punës për AKK dhe institucionet tjera përgjegjëse lidhur me ecurinë e procesit të rindërtimit;

1.11. Aprovimi i ZK apo të një pjese të ZK të rindërtuar.

Neni 8

Emërimi dhe përbërja e Komisionit për plotësimin ose korrigjimin e të dhënave në kadastër

1. Komisioni për plotësimin ose korrigjimin e të dhënave në kadastër përbëhet prej tre (3) anëtarëve:

1.1. Një jurist nga AKK, kryesues i komisionit;

1.2. Një ekspert nga fusha e kadastrit nga AKK, anëtar dhe

1.3. Një ekspert për gjeodezi, kadastër apo jurist, nga ZKK, anëtar.

2. Kryesuesi dhe anëtarët e komisionit, përveç përgatitjes profesionale nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të kenë edhe së paku dy (2) vite përvojë pune në fushën përkatëse.

3. Komisioni formohet me vendim të Drejtorit Ekzekutiv të AKK-së.

4. Anëtarët e Komisionit caktohen për kohën sa zgjat projekti.

Neni 9

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Komisionit për Plotësimin ose Korrigjimin e të Dhënave në Kadastër

1. Kompetencat dhe përgjegjësitë e komisionit janë:

1.1 Shqyrtimi dhe vendosja e rasteve që kanë të bëjnë me plotësimin ose korrigjimin e të dhënave në kadastër gjatë projektit;

1.2. Kontrolli i zbatimit të planit të informimit publik dhe materialeve të përgatitura nga OE për informimin publik;

1.3. Përcaktimi i kohës dhe vendit për mbajtjen e informimit publik për banorët e ZK të përfshira në projekt;

1.4. Koordinimi i aktiviteteve dhe bashkëpunimi me AKK, dhe OE, lidhur me marrjen dhe shkëmbimin e informatave dhe praninë dorëzimin e të dhënave;

1.5. Bashkëpunimi me institucionet dhe personat me autorizime publike për shfrytëzimin e të dhënave të nevojshme për plotësimin ose korigjimin e të dhënave në kadastër;

1.6. Shqyrtimi i kërkesave të OE lidhur me zbatimin e planit të projektit dhe ndërhyrja në eliminimin e pengesave gjatë procesit të realizimit të projektit;

1.7. Kërkon nga OE që të eliminojë parregullsitë, në rastet kur e vlerëson se plani i projektit nuk po zbatohet ashtu siç është aprovuar. Nëse nuk eliminohen parregullsitë i propozohet AKK-së që të bëjë ndërprerjen e punëve të OE dhe shkëputjen e kontratës;

1.8. Aprovimi i ZK apo të një pjese të ZK në të cilën është realizuar projekti në rastet kur bëhet vetëm për plotësimin apo korigjimin e të dhënave në kadastër;

1.9. Përgatitja e raporteve të punës për AKK dhe institucionet tjera përgjegjëse lidhur me ecurinë e zbatimit të projektit.

2. Komisioni merr vendime për plotësim ose korigjim të të dhënave. Në rast kur ekziston nën komisioni vendimet i merr pas rekomandimeve të nën komisionit nga neni 11 paragrafi 2 të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 10

Ushtrimi i detyrave nga Komisionet

1. Në rastet e zhvillimit të projektit për Rindërtimin e Kadastrit, nga neni 38 par.1, nën paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit, aktivitetet që janë në përshkrimin e kompetencave dhe përgjegjësi të të dy komisioneve ushtrohen nga Komisioni për shqyrtimin dhe vendosjen e zyrtarizimit të gjendjes faktike dhe mospërputhjeve me RDPP, me mbështetjen e nën komisioneve.

2. Komisioni për plotësimin ose korigjimin e të dhënave në kadastër në rastet kur nuk është duke u zhvilluar ndonjë projekt i RK nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të ushtroj kompetenca dhe përgjegjësi të tij në realizimin e projektit të veçantë për plotësimin ose korigjimin e të dhënave në kadastër.

Neni 11

Nën-Komisionet

1. AKK për mbështetje të komisioneve formon:

1.1. Nën-komision për shqyrtimin dhe vendosjen e zyrtarizmit të gjendjes faktike dhe mospërputhjeve me RDPP.

1.2. Nën-komision për plotësimin ose korrigjimin e të dhënave në kadastër.

2. Anëtarët e nën komisionit caktohen për kohën sa zgjat projekti i caktuar.

Neni 12 **Përbërja e nën-komisioneve**

1. Nën komisioni përbëhen nga tre (3) anëtar:

1.1. Një jurist, kryesues,

1.2. Një ekspert nga fusha e kadastrit, anëtar dhe

1.3. Një ekspert për gjeodezi, kadastër apo jurist, anëtar.

2. Kryesuesi dhe anëtarët e komisionit, përveç përgatitjes profesionale nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të kenë edhe së paku dy (2) vite përvojë pune në fushën përkatëse.

Neni 13 **Kompetencat dhe përgjegjësitë e nën-komisioneve**

1. Nën-komisioni për shqyrtimin dhe vendosjen e zyrtarizmit të gjendjes faktike dhe mospërputhjeve me RDPP ka kompetencat dhe përgjegjësitë si vijon:

1.1. Shqyrton rastet për njohjen dhe zyrtarizimin e të drejtave pronësore jo kontestimore mbi pronat e paluajtshme për rastet e trashëgimive të pa të pa formalizuara për të cilat nuk ka pasur azhurnime në regjistër pas fillimit të funksionimit të sistemit Noterial në Kosovë dhe i propozon Komisionit aprovimin apo refuzimin e tyre;

1.2. Shqyrton rastet për njohjen e pronësisë në rastet e shitblerjeve sipas marrëveshjes jo formale/ gojore, të cilat kanë mbetur të pa zyrtarizuara para fillimit të projektit RK dhe i propozon Komisionit aprovimin apo refuzimin e tyre;

1.3. Përgatitë, në bashkëpunim me OE dhe propozon hapjen e shikimit publik, përfshi shpalljen e datës, organizimin dhe udhëheqjen e shikimit publik.

1.4. Merr deklarata të palëve, siguron dokumentacionin dhe provat e nevojshme për vendimmarrje;

1.5. Mbështetë Komisionin në shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të pronarëve, përgatitë mbajtjen e seancave dëgjimore për shqyrtimin e kërkesave apo ankesave dhe nxjerrjen e vendimeve për secilin rast të paraqitur gjatë shikimit publik;

- 1.6. Mbështet Komisionin për realizimin e përgjegjësive dhe kompetencave nga neni 7 i këtij Udhëzimi;
- 1.7. Propozon aprovimin e të dhënave të rindërtuara;
 2. Nën-komisioni për plotësimin ose korrigjimin e të dhënave në kadastrë ka kompetencat dhe përgjegjësitë si vijon:
 - 2.1. Shqyrton rastet e plotësimit ose korrigjimit të të dhënave kur të dhënat kadastrale nuk janë të plota apo janë me gabime dhe ia dërgon komisionit për aprovim;
 - 2.2. Mbështet Komisionin për realizimin e përgjegjësive dhe kompetencave nga neni 9 i këtij Udhëzimi administrativ;
 - 2.3. Përgatitë dhe propozon kohën dhe vendin për informim publik për banorët e ZK të përfshira në projekt;
 - 2.4. Bashkëpunon me institucionet dhe personat me autorizime publike për shfrytëzimin e të dhënave të nevojshme për sigurimin e dokumentacionit dhe provave për vendimmarrje për korrigjimin e të dhënave kadastrale jo të plota apo me gabime.
3. Nën-komisionet për punën e vet mbajnë procesverbale.
4. Nën-komisionet i përgjigjen komisionit. Puna që kryhet nga nën-komisionet shqyrtohet dhe aprovohet nga komisioni.
5. AKK nxjerr udhëzues pune për punën e nën-komisioneve.

Neni 14 **Mënyra e punës në Komisione**

1. Komisioni vendimet i merr në mbledhjet e veta;
2. Komisioni takohet në mbledhje së paku një (1) herë në javë. Komisioni mund të takohet edhe më shpesh kur kryesuesi konstaton se është e domosdoshme, dhe në rastin kur këtë e kërkojnë së paku dy (2) anëtarë të Komisionit.
3. Takimet thirren dy (2) ditë përpara, përpos nëse takimi është urgjent. Takimet lajmërohen nga kryesuesi ose nga personi i autorizuar. Thirrjes për takim i bashkëngjitet rendi i ditës me pikat që do të diskutohen. Rendi i ditës hartohet nga kryesuesi i komisionit.
4. Takimi mund të mbahet nëse në të marrin pjesë shumica e anëtarëve të komisionit.
5. Për takimet e komisionit mbahen procesverbale, të cilat aprovohen në mbledhjet e ardhshme.
6. Komisioni përpilon Planin e punës bazuar në Planin e projektit.

7. Komisioni raporton çdo tre (3) muaj lidhur me progresin e projektit.
8. Plani i punës dhe raportet tremujore i dërgohen Drejtorit Ekzekutiv të AKK-së.

Neni 15 **Vendimmarrja nga Komisionet**

1. Për zyrtarizimin e gjendjes faktike dhe mospërputhjeve me RDPP dhe për plotësimin ose korigjimin e të dhënave në kadastër, Komisionet nxjerrin Vendim.
2. Vendimi merret me shumicën e votave të anëtarëve të komisionit.
3. Në takimin që vendoset për marrjen e vendimit përfundimtar për atë se a është rindërtuar ZK, në mbledhje duhet të marrin pjesë të gjithë anëtarët e komisionit. Ndërsa për vendim pozitiv duhet të votojnë se paku 2 anëtar të komisionit.
4. Vendimet e komisionit janë bazë ligjore për regjistrimin e pronave dhe të drejtave pronësore në RDPP dhe/apo e plotësimeve ose korigjimeve të të dhënave në kadastër.

Neni 16 **Përkrahja e Komisionit**

1. AKK-ja dhe ZKK-ja janë të obliguara që ta përkrahin komisionin në punën e vetë.
2. Me kërkesën e komisionit, të gjitha institucionet qendrore dhe lokale duhet t'ia dorëzojnë komisionit të dhënat që i posedojnë e që janë të rëndësishme për projekt. Afati për dorëzimin e dokumentacionit caktohet nga komisioni.
3. Selia e komisionit është në AKK, e cila duhet të siguroj kushte për punën e komisionit duke përfshirë: zyrën, pajisjet teknike dhe materialet për punë.
4. Për mbështetjen dhe përkrahjen e Komisioneve dhe nën komisioneve në kuadër të AKK-së, Drejtori Ekzekutiv i AKK-së cakton një apo më shumë zyrtar, varësisht nga nevoja.

Neni 17 **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ shfuqizohet Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2012 për Punën e Komisionit për Rindërtimin e Kadastrit dhe Regjistrin të të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme.

Neni 18 **Dispozitat përfundimtare**

Për zbatimin e plotë të këtij Udhëzimi Administrativ, AKK mund të nxjerr Udhëzues.

Neni 19
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Liburn ALIU

Ministër i Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Datë 07.05.2024

Prishtinë